

SUBSTANCA DHE GJENDJA E ZBATIMIT TË MARRËVESHJEVE TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Tetor 2019

Supported by:



Norwegian Embassy



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59 A · Nr. 10
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

SUBSTANCËN DHE GJENDJEN E ZBATIMIT TË MARRËVESHJEVE TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Tetor 2019

STUDIM

MBI

SUBSTANCËN DHE GJENDJEN E ZBATIMIT TË
MARRËVESHJEVE TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat	i
I. Hyrje	1
II. Historiku i Përgjithshëm	1
III. Marrëveshjet Specifike: Dialogu Teknik	3
A. Marrëveshjet e Negociuara/Përfunduara në Nivelin Teknik	3
1. Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes (Sistemi i Kartës së Identitetit) (korrik 2011)-	3
2. Marrëveshja për Regjistrin Civil (korrik 2011)	3
3. Marrëveshja për Pranimin Reciprok të Diplomave (korrik and nëntor 2011)	4
4. Marrëveshja Për Vulat Doganore (shtator 2011)	5
5. Marrëveshja për Kadastrën (shtator 2011).....	5
6. Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) (dhjetor 2011)-	6
7. Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal (shkurt 2012)	8
8. Marrëveshja për Zyrtarët Ndërlidhës (tetor 2011)	10
B. Marrëveshjet e negociuara / të përfunduara në nivelin politik (kryeministrat)	11
9. Marrëveshja për Mbledhjen e të Hyrave Doganore (janar 2013)	11
10. Marrëveshja për Telekomunikacion (shtator 2013)	12
11. Marrëveshja për Energjinë (shtator 2013)	13
IV. Marrëveshjet Specifike: Dialogu Politik	14
1. Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve ("Marrëveshja e Brukselit") (prill 2013).....	14
2. Marrëveshja për Drejtësinë dhe Gjyqësorin (prill 2013 dhe mars 2015).....	15
3. Marrëveshja për Sigurinë ("Mbrojtja Civile" - Shpërbërja dhe Integrimi i Personelit në Institucionet e Kosovës) (mars 2015).....	15
4. Marrëveshja për reciprocitet në targa të automjeteve (shator 2016).....	17
5. Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore (gusht 2015)	17
6. Marrëveshja për Urën e Mitrovicës (Plani i BE-së për Zbatim)	18
V. Përfundimet dhe Rekomandimet	20

Shkurtesat

ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
BE	Bashkimi Evropian
BNT	Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
EEAS	Shërbimi i Veprimit të Jashtëm
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Sistemeve të Transmisionit dhe
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUSR	Përfaqësuesit Specialë të Bashkimit Evropian
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike
MC	Mbrojtja Civile
MIK	Menaxhimi i Integruar I Kufirit
NNL	Ndihma e Ndërsjellë Ligjore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pikëkalimet Kufitare
SGKM	Sistemi Global për Komunikimet Mobile
UNESCO	Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projektit

I. Hyrje

Ky studim synon të ofrojë një pasqyrë që është sa e plotë dhe praktike aq edhe e nevojshme për të artikuluar përmbajtjen dhe statusin kryesor të zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Rendi i marrëveshjes do të shqyrtohet bazuar në kohën e përfundimit të tyre.

Procesi i dialogut ndahet në dy faza: faza e parë është e përbërë nga i ashtuquajtimi “dialogu teknik”, kurse faza e dytë nga, “dialogu politik”. Dialogu teknik pastaj ndahet në nën-faza të tilla si (1) marrëveshjet e arritura në nivel teknik dhe (2) marrëveshjet e negociuara nga ose të përfunduara në nivelin politik (d.m.th. Kryeministrat).

Përpara një diskutimi të detajuar për secilën nga marrëveshjet e përfunduara, ky studim ofron një sfond të përgjithshëm të procesit të dialogut që ka rezultuar me përfundimin e marrëveshjeve.

Çdo marrëveshje është prezantuar ashtu që të përcaktojë përmbajtjen e saj kryesore, përpjekjet për zbatimin e marrëveshjeve nga të dyja palët në rast të mungesës së progresit ose moszbatimit, përfshirë këtu edhe pengesat dhe arsyet e mundshme për moszbatim apo zbatim të pjesshëm dhe një përbërës i tretë i cili përcakton shkurtimisht statusin e zbatimit (nga “përfunduar” në “jo të zbatuar” ose nga “pak përparim” në “pa përparim”, etj.).

II. Historiku i Përgjithshëm

Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Procedurat këshillimore u nisën më pas përpara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Gjykata lëshoi Opinionin Këshillëdhënës më 22 korrik 2010, duke mos gjetur shkelje të së drejtës ndërkombëtare ose ligjit të posaçëm të përfshirë në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo edhe Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë.

Pas Mendimit të Gjykatës, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, organi kërkues i Mendimit Këshillëdhënës, miratoi me konsensus rezolutën Nr. 64/298. Në këtë rezolutë, ajo pranoi përmbajtjen e Mendimit Këshillëdhënës dhe mirëpriti gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të ndihmuar një proces dialogu midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas paragrafit 2 të rezolutës, “procesi i dialogut në vetvete do të ishte një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe do të promovonte bashkëpunimin, arritjen e progresit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe përmirësimin e jetës së njerëzve”.¹

Rezultati pasues i këtij procesi u bë i njohur si “dialog teknik” midis Kosovës dhe Serbisë. Takimi i parë i këtij procesi të dialogut filloi më 8 mars 2011. Marrëveshjet e para u nënshkruan më 2 korrik 2011. Këto marrëveshje përfshinë lirinë e lëvizjes, regjistrin civil dhe njohjen reciproke të diplomave universitare. Në të vërtetë, gjithsej trembëdhjetë (13) marrëveshje kanë përfunduar gjatë fazës së parë të dialogut teknik. Në disa raste, marrëveshje të caktuara shoqërohen me veprime pasuese ose plane zbatimi siç është plani për zbatimin e marrëveshjes për njohjen reciproke të diplomave (prill 2016) ose plani lidhur me finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes (shtator 2016).

Si pjesë e fazës së dytë, politike të dialogut, marrëveshja kryesore është e ashtuquajtura “Marrëveshja e Brukselit”, e cila formalisht është titulluar si Marrëveshja e Parë e Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve të 19 prillit 2013. Marrëveshja synon vendosjen e kornizës për Kosovën, që më në fund të konsolidojë kontrollin e saj mbi zonën e trazuar, kryesisht serbe, veriore të vendit. Për qëllime të këtij studimi, ky seksion është zgjeruar për të adresuar në mënyrë specifike pjesë të kësaj marrëveshjeje ose plane më të detajuara dhe më të zhvilluara të zbatimit që kanë të bëjnë me (a) drejtësinë/gjyqësinë; (b) sigurinë; (c) reciprocitetin në tregat e automjeteve; (d) Asociacionin/Bashkësinë e Komunave Serbe; dhe (e) Urën e Mitrovicës.

¹ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2010), ‘Kërkesë për mendim këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëse deklarata e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare’. Në dispozicion në: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/ROL%20A%20RES64%20298.pdf> [Qasur më: 9 tetor 2019].

III. Marrëveshjet Specifike: Dialogu Teknik

A. Marrëveshjet e Negociuara/Përfunduara në Nivelin Teknik

1. Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes (Sistemi i Kartës së Identitetit) (korrik 2011)²⁻³

a. Përmbajtja

Më 2 korrik 2011, Kosova dhe Serbia ranë dakord që banorët e dy shteteve duhet të jenë në gjendje të udhëtojnë lirshëm “brenda ose përmes territorit të tjetrit”. Kjo marrëveshje do të realizohet nga një sistem i kartës së identitetit për udhëtimin "kufirit/ndërkufitar" nga pala tjetër, me anë të përdorimit të dokumenteve hyrëse/dalëse. Të dy palët ranë dakord të ju mundësojnë banorëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të tjetrit. Palët gjithashtu u pajtuan për një zgjidhje të përkohshme lidhur me blerjen e sigurimeve afatshkurtër të automjeteve, përderisa punonin për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve.

b. Gjendja e Zbatimit: E Përfunduar/ E Zbatuar

2. Marrëveshja për Regjistrin Civil (korrik 2011)⁴

a. Përmbajtja

Gjithashtu, më 2 korrik 2011, të dyja palët u pajtuan që një komitet trepalësh i përbërë nga ekspertët e regjistrin civil nga të dy anët dhe të kryesuar nga misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX), do të identifikonte çdo boshllëk në librat e gjendjes civile para vitit 1999.

² Zyra e Kryeministrit (2011), 'Klauzolat e Dakorduara 2 korrik 2011 – Liria e Lëvizjes'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_0210_liria.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

³ Zyra e Kryeministrit (2011), 'Konkluzionet përfundimtare operative, grupi implementues për lirinë e lëvizjes'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_perfundimtare_operative_grupi_implementues_per_lirine_e_levizjes_29_nentor_2011.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

⁴ Zyra e Kryeministrit (2011), 'Klauzolat e Dakorduara 2 korrik 2011 – Regjistrat Civil'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/agreement_0210_civil_books.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

Serbia ra dakord që të bëj kopje të regjistrave origjinalë, të cilët pas certifikimit nga EULEX-i do të ktheheshin në Kosovë.

b. Gjendja e zbatimit: E Përfunduar/ E Zbatuar

3. Marrëveshja për Pranimin Reciprok të Diplomave (korrik and nëntor 2011)⁵

a. Përmbatja

Më 21 nëntor 2011, Kosova dhe Serbia u pajtuan që të kërkojnë nga Shoqata Evropiane e Universiteteve certifikimin e diplomave universitare për përdorim nga pala tjetër, qoftë për arsim të lartë apo për punësim në sektorin publik.

Pjesa përfundimtare e marrëveshjes parashikon që “BE-ja do të bëjë çdo përpjekje për të siguruar zbatimin e konkluzioneve të mësipërme deri më 1 janar 2012”.⁶

Më 29 shtator 2015, përsëri, të dy palët ranë dakord të angazhohen për të njohur diplomat e vendit tjetër brenda pesë muajve dhe secila palë të krijojë një listë të universiteteve të tyre të akredituara, me qëllim të transparencës.

b. Përpjekjet për zbatim

Që nga viti 2011, kur kjo marrëveshje u arrit fillimisht dhe më pas u zgjerua, ajo kurrë nuk është zbatuar nga Serbia. Motivet për bllokadë duket të jenë të një natyre politike dhe me sa duket janë të orientuara kundër shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të cilëve veçanërisht ju nevojitet pranimi i diplomave të tyre, duke qenë se ata studiojnë në Kosovë në mungesë të një institucioni të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Pasi të diplomohen, ata kërkojnë të kthehen në shtëpi dhe të shërbejnë në sektorin e arsimit ose të punësohen në sektorë të tjerë publikë.

c. Gjendja e zbatimit: E papërfunduar/Pa përparim

⁵ Zyra e Kryeministrit (2011), ‘Klauzolat e Dakorduara– Pranimi i Diplomave Universitare’. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_0210_universitare.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

⁶ Po aty., fq.2.

4. Marrëveshja Për Vulat Doganore (shtator 2011)⁷

a. Përmbajtja

Më 2 shtator 2011, të dyja palët ranë dakord me pranimin e vulave doganore të Kosovës dhe u angazhuan për të siguruar lirinë e lëvizjes së mallrave në përputhje me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).

Ndonjëherë vërehen pengesa në përdorimin e vulave paralele doganore nga Autoritetet Doganore të Beogradit. Këto raste raportohen në BE.

b. Gjendja e zbatimit: E përfunduar/E zbatuar (pengesat e mundshme raportohen)

5. Marrëveshja për Kadastrën (shtator 2011)⁸

a. Përmbajtja

Më 2 shtator 2011, palët ranë dakord të sigurojnë një regjistër të plotë kadastral për Kosovën me një proces të ngjashëm siç është përcaktuar në marrëveshjen e regjistrimit civil.

Ekipet trepalëshe, të kryesuar nga përfaqësues të BE-së nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm (EEAS) dhe me ekspertë kadastralë nga të dy vendet, duhej të monitoronin punën e agjencisë teknike. Agjencia do të identifikonte mangësitë në dokumentet kadastrale para vitit 1999. Dokumentet duhej të skanoheshin e të verifikoheshin dhe pastaj t'i dorëzoheshin EUSR-së.

Dokumentet e kthyer do të krahasoheshin me kadastrën ekzistuese të Kosovës nga një agjenci teknike që do të krijohej në Kosovë. Dallimet do të duhej të trajtoheshin nga një mekanizëm gjykimi, i cili do të përbëhej nga një komision i ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve mbi pronën dhe kadastrën në Kosovë.

Gjykata Supreme e Kosovës do të jetë organi përfundimtar i ankesës për vendimet mbi pronësinë që dalin nga dallimet mes kadastrave.

⁷ Zyra e Kryeministrit (2011), 'Klauzolat e Dakorduara 2 shtator 2011 – Vula Doganore. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_0210_vula.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

⁸ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Gjendja në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 26. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjenzezbatimineMarreveshjeveteBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

b. Përprojekjet për Zbatim

Pavarësisht arritjes së marrëveshjes në vitin 2011, ka pasur vonesa serioze në zbatim. Këto vonesa u shkaktuan fillimisht nga Kosova nga mos miratim i Ligjit për Agjencinë Teknike për Krahasimin dhe Verifikimin e Dokumenteve Kadastrale që do të ktheheshin në Kosovë, të cilat ishin marrë me forcë nga Serbia gjatë luftës kundër Kosovës në 1998-1999. Megjithatë, që kur Kosova e miratoi këtë ligj në qershor 2016, Serbia ka qenë duke e stagnuar zbatimin duke mos kthyer në Kosovë kopjet e verifikuara të regjistruara kadastrale.

c. Gjendja e zbatimit: Disa përparime në zbatim

6. Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) (dhjetor 2011)⁹⁻¹⁰

a. Përmbajtja

Në kontekstin e BE-së, MIK qëndron për “Menaxhim të Integruar të Kufirit”. Ky është një komponent kyç i anëtarësimit. Për shkak se Serbia nuk e njeh Kosovën, preferon termin “Menaxhimi i Integruar i Kufirit”. Në negociatë, është përdorur vetëm akronimi “MIK”, i cili konsiderohet si “status neutral”.

Më 2 dhjetor 2011, palët u pajtuan të zbatojnë konceptin e BE-së për MIK, duke rënë dakord që gradualisht të vendosin pikat e përbashkëta kufitare “sa më shpejt që të jetë e mundur”. Ata u dakorduan që të kenë një prani të ekuilibruar të personelit të secilës anë dhe të mos shfaqin simbolet shtetërore. Palët gjithashtu u pajtuan që zyrtarët e EULEX-it të jenë të pranishëm në gjashtë pikat kufitare.

Më 4 shtator 2014, të dyja palët arritën një marrëveshje me BE-në për të ndërtuar objekte të përhershme në pikat e kalimit kufitar, të cilat do të financoheshin me 21 milionë euro të dhuruara në Instrumentin e BE-së për fondet e para-pranimit për Kosovën dhe Serbinë (3 Kufinjë/Pikëkalime kufitare).

⁹ Zyra e Kryeministrit (2012), ‘Protokolli Teknik për zbatimin e Konkluzave të Dakorduara të Dialogut IBM-it – 2 dhjetor 2011’. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Protokolli_Teknik_i_IBM_-_23_shkurt_2012.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

¹⁰ Zyra e Kryeministrit (2012), Plani Final i Veprimit i Grupit Zbatues (GZ) për Protokollin Teknik për MIK. Në dispozicion në: [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ZKM-ALB-IBM_Action_Plan_final_-_04_December_2012_\(2\).pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ZKM-ALB-IBM_Action_Plan_final_-_04_December_2012_(2).pdf) [Qasur më: 9 tetor 2019].

Më 21 maj 2015, Kosova dhe Serbia ranë dakord që të hapin dy pika të reja të kalimit kufitar MIK (PKK), një pranë zonës së banuar me shqiptar të Luginës së Preshevës dhe Medvegjës në Serbi, në Kapia/Vrapç dhe një tjetër në veriun e Kosovës të banuar serb, në Rajetici/Izvor.¹¹ I pari është i drejtuar nga Kosova dhe i dyti nga Serbia. Sipas marrëveshjes, PKK-të janë të hapura 24/7, por funksionet doganore mund të bëhen vetëm gjatë ditës.

b. Përpyekjet për zbatim

Zbatimi i MIK-së është në një nivel mjaft të lartë, një rezultat i dukshëm i bashkëpunimit konstruktiv mes autoriteteve kufitare të të dy vendeve.

Faza e dytë e zbatimit që përfshin ndërtimin e objekteve të përhershme në të gjitha gjashtë vendkalimet kufitare është në zhvillim e sipër, megjithëse ende nuk ka përfunduar plotësisht.

Pala e Kosovës do të drejtoj tre PKK në Merdarë, Bërnjak dhe Mutivodë, ndërsa pala serbe do të drejtoj tre PKK të tjerë në Jarinjë, Dheu i Bardhë dhe Muqibabë. Plani i objekteve të përhershme është nënshkruar nga të tre palët, Kosova, Serbia dhe BE-ja në shtator 2014. Dukja e objekteve të përhershme është dizajnuar nga kompania e kontraktuar nga BE-ja SAFEGE në konsultim të ngushtë me secilën palë.

Në objektet e përhershme të MIK-së, Kosova ka bërë një përparim të dukshëm në kompletimin e planit përfundimtar të projektit në bashkëpunim me BE dhe UNOPS si partnerë implementues. Më 14 shtator 2016, Qeveria e Kosovës miratoi planin përfundimtar të projektit për kalimet kufitare në Merdarë, Bërnjak/Tabavije dhe Mutivodë, për të cilat Kosova është pala drejtuese.

Sidoqoftë, pala serbe nuk po bën përparime të shpejta në zbatimin e objekteve të përhershme të MIK-së në tri kalimet kufitare për të cilat ata janë partneri drejtues. Në takimin e fundit të MIK-së, pala serbe ka raportuar disa hapa që ata kanë ndërmarrë, të cilat megjithatë janë larg përfundimit të planeve finale të projektit, pavarësisht se

¹¹ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 23. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjennezbatimineMarreveshjeveteBrukselit16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

partneri zbatues i zgjedhur nga BE, d.m.th UNOPS-i, ka treguar gatishmëri për të bërë përparime në këtë aspekt.

Progres i rëndësishëm është bërë në zbatimin e Shkëmbimin Sistematik të të Dhënave Elektronike mbi Doganat. Nga ana tjetër, zbatimi i Ndhmës së Ndërsjellë Ligjore (NNL) nuk ka qenë i kënaqshëm. Serbia thuhet se i ka vonuar përgjigjet ndaj Kosovës.

c. Gjendja e zbatimit: Përparim në zbatim

7. Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal (shkurt 2012)¹²

a. Përmbajtja

Më 24 shkurt 2012, palët ranë dakord, në mënyrë të përkohshme, që Kosova mund të merrte pjesë në organet rajonale, me kusht që emri i saj të shfaqej me një yll, me një shënim duke iu referuar Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë) për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Palët më tej ranë dakord se çdo marrëveshje e re do të përfshinte Kosovën me yll, domethënë Kosova*.

Marrëveshja parasheh që të dyja palët të konfirmojnë angazhimin e tyre për një bashkëpunim rajonal efektiv, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues. Kosova merr pjesë vetë, flet dhe nënshkruan vetë në takimet rajonale, ku Kosova* është i vetmi emërim që do të përdoret.

b. Përprjekjet për zbatim

Progresi është i evidentuar në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Kosova është pranuar në një numër institucionesh rajonale dhe ndërkombëtare. Kosova u bë anëtare me të drejta të plota në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit më 14 qershor 2016.¹³ Kosova ka hyrë në Konventën e Apostilit të Hagës më 15 korrik 2016. Përveç kësaj, Prokurori i Shtetit i Kosovës u bë anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve më 29 tetor 2016, kurse

¹² Zyra e Kryeministrit (2012), 'Konkluzionet e Dakorduara 24 shkurt 2012 – Aranzhimet lidhur me Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_0210_arranzhime.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

¹³ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 24. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjenzebhatimineMarreveshjeveteBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

Kosova zyrtarisht u bë pjesë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 10 tetor 2016, ku Delegacioni Parlamentar i Kosovës do të jetë në gjendje të marrë pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e organeve të tjera të këtij institucioni. Oda Ekonomike e Kosovës u bë anëtare e plotë e Shoqatës Evropiane të Dhomave të Tregtisë (Euro-Dhoma) më 18 tetor 2016.

Kosova ka marrë pjesë në takime të nivelit të lartë ndërkombëtar dhe rajonal si e barabartë me shtetet e tjera. Këtu janë disa nga të dhënat: delegacioni i Kosovës mori pjesë në takimin A-5 të Kartës së Adriatikut lidhur me çështjet e sigurisë në Zagreb më 12 nëntor 2016; Delegacioni i Kosovës nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike mori pjesë në trajnimin në Sofje të Bullgarisë më 23 tetor 2016, organizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat; Oda Ekonomike e Kosovës mori pjesë për herë të parë si anëtare e barabartë me të drejtë vote në Edicionin Vjetor të Sipërmarrësve të Parlamentit Evropian më 14 tetor 2016; Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ishte pjesë e panelit në Forumin Ekonomik Ndërkombëtar në Toronto, më 11 shtator 2016, ku ishin të pranishëm delegatë nga mbi 40 vende; Unioni i Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Evropës vendosi Bashkimin e Asociacionit të Kontrolluesve të Trafikut Ajror të Kosovës në hartën e ngjarjeve në fushën e Aviacionit në Evropë më 27 shtator 2016.¹⁴

Serbia vazhdon të paraqes pengesa në procesin e anëtarësimit të Kosovës si në organizatat rajonale ashtu edhe në organizatat ndërkombëtare. Raste të evidentuara si në Sondazhet Gjeologjike të Evropës (Euro Geo Surveys), ku Asambleja e Përgjithshme e Organizatës, e cila u mbajt nga 10-15 tetor 2016 në Lubjanë, nën ndikimin e Delegacionit të Serbisë, vendosi në agjendë kërkesën për heqjen e Kosovës. Serbia vazhdon me fushatat kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe INTERPOL dhe paraqet pengesa brenda Federatës Botërore të Volejbollit, ku Kosova tashmë është anëtare. Më 25 tetor 2016, Serbia kërkoi nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Private që të refuzojë pjesëmarrjen e Delegacionit të Kosovës në një forum ekspertësh të njohur si Komiteti Special, sipas Konventës së Apostille, përkundër faktit se Kosova është pjesë e Konventës së Apostillit që nga 15 korriku i vitit 2016.¹⁵

¹⁴ Po aty., p.24

¹⁵ Po aty., p.24

Në takimet e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, Serbia dërgoi një notë verbale, duke deklaruar se kjo nuk do të thotë njohje dhe nuk paragjykon statusin e Kosovës. Më 13 tetor 2016, Serbia i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, duke protestuar për pjesëmarrjen e Delegacionit të Kosovës më 11 tetor 2016 në Konferencën për linçimin e Komentarit të Katërt Tematik mbi zbatimin e Konventës për Mbrojtjen e Minoritetet Kombëtare, të organizuara nga Komiteti Këshillëdhënës. Më 26 shtator 2016, një anëtar i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës u ndalua në Aeroportin e Beogradit dhe nuk u lejua të merrte pjesë në një takim të autoriteteve rajonale. Ai u mbajt në Beograd me arsyetimin se dokumentet e Kosovës nuk janë të vlefshme. Një shembull shtesë përfshin: Prezantimi i Kosovës sipas Rezolutës 1244 në Procesin Ministror të Iniciativës së Pragës, mbajtur në Bratislavë, Sllovaki më 21 shtator 2016, e detyroi Ministrin e Punëve të Brendshme të largohet nga konferenca.¹⁶

c. Gjendja e zbatimit: Njëfarë progresi; Nuk zbatohet plotësisht

8. Marrëveshja për Zyrarët Ndërlidhës (tetor 2011)¹⁷

a. Përmbajtja

Të dyja palët kanë rënë dakord në vitin 2011 që të kenë zyrarë ndërlidhës të qeverive përkatëse, të vendosur në kryeqytetet e njëri-tjetrit.

Palët u pajtuan më tej në Bruksel në shtator 2014 se ata do të jenë përgjegjës vetëm për vizitat zyrtare.

Një marrëveshje e kohëve të fundit që i lejonte çdo zyre një anëtar shtesë të stafit, gjithashtu u arrit, por nuk është zbatuar plotësisht për shkak të kufizimeve të hapësirës.

Misioni i Zyrave Ndërlidhëse është që të marrë pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve dhe adresimin e problemeve të përditshme që mund të ndodhin. Zyrat ofrohen nga Delegacionet e BE-së në të dy vendet. Bashkimi Evropian

¹⁶ Po aty., p.25.

¹⁷ Zyra e Kryeministrit (2013), 'Konkluzionet e Kryesuesit – Marrëveshjet Ndërlidhëse'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Konkluzionet_e_kryesuesit_-_Marreveshjet_nderlidhese.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

ofron lehtësime për të arritur këto marrëveshje dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre në përputhje me praktikat e BE-së.

b. Përpyekjet për zbatim

Qeveria e Kosovës e konsideron marrëveshjen si të zbatuar në mënyrë korrekte, megjithatë nën minimumin e kushteve për Zyrat Ndërlidhëse. Asnjë përparim nuk është bërë në avancimin e rolit të të dy Zyrtarëve Ndërlidhës. Për shembull, marrëveshja për personelin e shtuar dhe lokalet ende nuk është implementuar. Simbolet zyrtare të të dy Zyrave Ndërlidhëse janë gjithashtu të padefinuara. Megjithëkëtë, shumë vizita zyrtare dypalëshe janë administruar nga të dy Zyrtarët Ndërlidhës në kryeqytetet përkatëse.¹⁸

c. Gjendja e zbatimit: Njëfarë progresi; Nuk zbatohet plotësisht

B. Marrëveshjet e negociuara / të përfunduara në nivelin politik (kryeministrat)

9. Marrëveshja për Mbledhjen e të Hyrave Doganore (janar 2013)¹⁹

a. Përmbajtja

Marrëveshja e Kosovës dhe Serbisë mbi vulat doganore dhe tregtinë e lirë u nënshkruan më 2 shtator 2011 dhe zbatimi filloi në fund të muajit të njëjtë, megjithëse nuk u zbatua në pikëkalimet veriore Jarinjë dhe Bërnjak deri në dhjetor 2013. Marrëveshja është e bazuar në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).

Sipas marrëveshjes së mbledhjes së të hyrave doganore, paratë e mbledhura në dy PKK-të veriore shkojnë në një 'fond për veriun', i cili deri më tani ka grumbulluar rreth 8 milionë euro dhe ka filluar tri projekte në veri të Mitrovicës për nxitjen ndërmarrjet e

¹⁸ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 21. Në dispozicion në:

https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjennezbatimineMarreveshjeveteBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfykj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

¹⁹ Zyra e Kryeministrit (2013), 'Marrëveshja e Brukselit mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Marreveshja_e_Brukselit_mbi_Mbledhjen_e_te_Hyrave_Doganore_17_Janar_2013.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

vogla dhe të mesme, shpronësimet e tokave për komunën e re dhe krijimin e një qendre për zjarrfikësit.

c. Gjendja e zbatimit: E përfunduar

10. Marrëveshja për Telekomunikacion (shtator 2013)²⁰

a. Përmbajtja

Më 8 shtator 2013, palët ranë dakord se BE-ja dhe Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, BNT, do t'i caktojnë Kosovës kodin e vet telefonik treshifror dhe do të largojnë tre kodet telefonike të përdorura në Kosova (Serbia dhe Sllovenia për linjat tokësore, dhe Sllovenia dhe Monako për celularë) deri në janar 2015. Palët gjithashtu ranë dakord të harmonizojnë spektrin për Sistemin Global për Komunikimet Mobile (SGKM) dhe sinjalet televizive, me të dyja palët që u pajtuan të mos shkelin qëllimisht kalimin kufitar/kufirin e tjetrit.

Më 25 gusht 2015, të dyja palët u pajtuan për një plan zbatimi për marrëveshjen e mëparshme të telekomit. Kosovës iu dha kodi +383 nga BNT.²¹

Serbia i kishte dërguar një letër BNT-së duke rënë dakord për një kod të thirrjeve për Kosovën, në përputhje me Marrëveshjen e Telekomit 2013 dhe planin pasues të veprimit të vitit 2015. Bazuar në këtë marrëveshje, Austria ka aplikuar në BNT dhe ka kërkuar që të përcaktohet kodi telefonik për Kosovën.

Kosova do të bashkëpunojë drejtpërdrejt me BNT-në për zbatimin e kodit shtetëror dhe do të administrojë në mënyrë të pavarur kodin e vet si të gjitha vendet e tjera. Autoriteti Rregullativ i Telekomit të Kosovës (ARKEP) është autoriteti zbatues në pajtim me Ligjin e Kosovës.

²⁰ Zyra e Kryeministrit (2013), 'Aranzhimet lidhur me Telekomunikacionin'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Aranzhimet_per_Telekomunikacionin_shqip_perkthim_jozyrat_08092013.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

²¹ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 8. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjennezbatimineMarreveshjevetBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

Marrëveshja për telekomunikacion përcakton që sapo të zbatohet kodi 383, pas periudhës së tranzicionit, të gjitha kodet e tjera ekzistuese 381, 377, 386 do të pushojnë së ekzistuari në Kosovë.

b. Gjendja e zbatimit: E zbatuar

11. Marrëveshja për Energjinë (shtator 2013)²²

a. Përmbajtja

Palët u pajtuan që organet e tyre përkatëse të transmisionit të energjisë, KOSTT-i i Kosovës dhe EMS-ja e Serbisë, brenda tre muajsh do të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe, duke krijuar dhe rregulluar marrëdhëniet midis dy operatorëve të sistemit të transmisionit. Të dy rregullatorët duhet të lëshojnë licenca për tregti (import, eksport, transit) dhe furnizim të kompanive shpërndarëse të vendit të tyre. Palët gjithashtu ranë dakord të krijojnë një kompani të re sipas ligjit të Kosovës që do të ofronte shërbime të shpërndarjes për komunat e veriut me shumicë serbe.

Kosova dhe Serbia gjithashtu u pajtuan që në të ardhmen të gjejnë një metodë të përbashkët për zgjidhjen e pretendimve që kanë kundrejt njëra-tjetrës për përdorimin e linjave të transmisionit, duke rënë dakord të kërkojnë arbitrazh ndërkombëtar nëse nuk ka zgjidhje brenda gjashtë muajve.

Më 25 gusht 2015, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT) nënshkroi një marrëveshje lidhjeje me Rrjetin Evropian të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E) dhe anëtarët e saj, që do të thotë se Kosova përfundimisht do të kontrollojë linjat e saj të transmisionit të energjisë dhe do të tarifojë kompanitë e vendeve të tjera për përdorimin e linjave të saj.

Si pjesë e marrëveshjes së ndërmjetësuar në Bruksel, dy kompani të reja, nga një shoqëri mëmë serbe, një për tregtimin e energjisë dhe një për furnizimin dhe shpërndarjen e saj, do të regjistrohen sipas ligjit të Kosovës dhe do të shërbejnë në pjesën veriore të Kosovës.

²² Zyra e Kryeministrit (2013), 'Aranzhimet lidhur me Energjinë'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Aranzhimet_per_energjiine_shqip_perkthim_jozyrtar_080913.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

b. Përpyjekjet për zbatim

Marrëveshja ende nuk mund të zbatohet. Serbia është duke e bllokuar duke mos lejuar që kompania e re të jetë e regjistruar në Kosovë në pajtim me Ligjin e Kosovës siç parashihet me marrëveshjen e energjisë të arritur në vitin 2013. Në terma konkretë, kompania e re, si një degë e kompanisë serbe, refuzon që ta përmendë Kosovën si shtet veprimi në statutin e saj, pavarësisht se marrëveshja kërkon respektimin e Ligjit të Kosovës. Këto pengesa duket të jenë të lidhura me mosdëshirën e Serbisë për ta zbatuar marrëveshjen për arsye politike dhe ekonomike. Duhet të theksohet se KOSTT ka fituar ligjërisht mosmarrëveshjen në vitin 2008, kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vendosi se Serbia ka shkelur Traktatin e Athinës në lidhje me Kosovën.²³

c. Gjendja e zbatimit: Progress i kufizuar (akoma jo plotësisht funksionale).

IV. Marrëveshjet Specifike: Dialogu Politik

1. Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve (“Marrëveshja e Brukselit”) (prill 2013)²⁴

Më 19 prill 2013, Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë nënshkruan Marrëveshjen e Parë mbi Parimet që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. Kjo përfaqëson një marrëveshje kornizë, të përbërë nga një sërë çështjesh, të cilat më vonë u detajuan në marrëveshje të veçanta dhe plane veprimi dhe të cilat do të adresohen më hollësisht në nën-seksionet e mëposhtme.

²³ Zyra e Kryeministrit (2017), ‘Marrëveshjet e Brukselit në Pritje të Zbatimit’. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/njoftim-per-media-ministrja-edita-tahiri-ka-paraqitur-nje-raport-zyrtar-prane-bashkimit-evropian-rreth-gjendjes-ne-zbatimin-e-marreveshjeve-te-brukselit/> [Qasur më: 9 tetor 2019].

²⁴ Zyra e Kryeministrit (2013), ‘Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve’. Në dispozicion në: http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

2. Marrëveshja për Drejtësinë dhe Gjyqësorin (prill 2013 dhe mars 2015)²⁵

a. Përmbajtja

Palët u pajtuan që autoritetet ekzistuese gjyqësore të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të krijojë një panel të përbërë kryesisht prej gjyqtarëve serbë të Kosovës për t'u marrë me të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Një ndarje e kësaj Gjykate të Apelit, e përbërë nga stafi administrativ dhe gjyqtarët, do të qëndrojë përherë në Mitrovicën veriore. Gjyqtarët serbë të Kosovës do të përbëjnë shumicën e secilit panel.

Më 10 shkurt 2015, të dyja palët u takuan në Bruksel dhe ranë dakord saktësisht se si do të duket struktura e gjyqësorit. Ata ranë dakord se kryetari i gjykatës do të jetë një serb i Kosovës nga veriu. Gjykata në Mitrovicën e Veriut do të ketë një divizion të ankesave me pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë, ndërsa një serb i Kosovës do të emërohet nënkryetar i gjykatës së apelit në Prishtinë. Kjo ndërtesë e gjykatës do të ketë gjithashtu divizionin e krimeve të rënda për të gjithë rajonin, i cili do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë. Gjithashtu, një numër i caktuar i punonjësve të shtetësisë serbe dhe shqiptare do të vendosen në secilën gjykatë dhe degë të saj.

b. Gjendja e zbatimit: E përfunduar/Zbatohet

3. Marrëveshja për Sigurinë ("Mbrojtja Civile" - Shpërbërja dhe Integrimi i Personelit në Institucionet e Kosovës) (mars 2015)²⁶

a. Përmbajtja

Policia e Kosovës (PK) do të jetë e vetmja polici që vepron në territorin e Kosovës. Të gjithë policët që punojnë në veri të Kosovës do të integrohen në PK dhe të gjitha pagat do të paguhën nga ai organ. Pjesëtarëve të strukturave të tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet një vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.

²⁵ Zyra e Kryeministrit (2015), 'Drejtësia'. Në dispozicion në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Agreement_on_Justice_-_9_Feb_2015_1.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

²⁶ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 16. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjenzebmatimineMarreveshjeveteBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

Një komandant rajonal i policisë do të mbikëqyrë katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviq). Komandanti do të jetë një serb, i emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës “nga një listë e ofruar nga katër kryetarët në emër të Asociacionit/Bashkësisë”. Përbërja etnike e njësisë rajonale të policisë do të pasqyrojë përbërjen etnike të katër komunave. Një komandant i veçantë rajonal do të jetë për Mitrovicën e Jugut, Skenderaj dhe Vushtrri, kurse komandanti rajonal i njësisë që mbulon katër komunat veriore do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë rajonal.

Paragrafi 8 i marrëveshjes së 19 prillit 2013 thotë se “anëtarëve të strukturave të tjera të sigurisë do të ju ofrohet një vend në strukturat ekuivalente të Kosovës”. Më 26 mars 2015, palët ranë dakord për një mekanizëm për integrimin e ish-anëtarëve të të ashtuquajturës Mbrojtje Civile, një organ serb i mbrojtjes civile i vendosur në veri të Kosovës, dhe gjithashtu u pajtuan që pronat e tyre t’i jepen Qeverisë së Kosovës për përdorim.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është pothuajse i përfunduar. Struktura e ashtuquajtur “Mbrojtja Civile” (MC) është mbyllur, ndërsa ish-anëtarët e saj (483) janë të integruar/të punësuar në institucionet civile të Kosovës. Janë 22 ministri dhe agjenci të cilat i kanë punësuar këta individë përmes procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes, bazuar në Ligjin e Kosovës. Të gjithë këta kanë marrë përshkrimet e punës dhe kanë nënshkruar kontrata pune me Qeverinë e Kosovës si nëpunës civilë. Kosova gjithashtu ka përfunduar seminarët për riintegrimin institucional në bashkëpunim me OSBE dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Kontratat për 433 punëtorë janë nënshkruar në janar 2016, ndërsa 50 kontrata u nënshkruan në gusht të vitit 2016.

Dorëzimi i objekteve të përdorura nga ish-MC për institucionet e Kosovës ende nuk ka ndodhur. Pas dorëzimit, Qeveria e Kosovës do t’i bëjë ato të disponueshme për komunat veriore me qëllim që të plotësojnë më mirë nevojat e tyre.

c. Gjendja e zbatimit: Pjesërisht e zbatuar

4. Marrëveshja për reciprocitet në targarat e automjeteve (shator 2016)²⁷

a. Përmbajtja

Marrëveshja e njohur si “Marrëveshjet për kompletimin e zbatimit të Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë të vitit 2011” krijon reciprocitet në targarat e automjeteve ndërmjet dy shteteve, duke filluar nga 15 nëntori 2016. Përfundimi i targave të paligjshme parashihet në 12 muaj, duke filluar nga 17 Janar 2017, dhe vazhdimi i targave KS edhe për pesë (5) vjet. Afati është zgjatur për shkak të vonesave të natyrës administrative nga ana e Kosovës.

b. Përprjekjet për zbatim

Kjo marrëveshje u arrit në shtator 2016 dhe ishte planifikuar të fillonte më 15 nëntor 2016. Kosova ka vonuar zbatimin e saj për shkak të vonesave në miratimin e vendimeve të nevojshme lidhur me zbatimin. Më 16 shkurt 2017, Qeveria e Kosovës miratoi këtë marrëveshje dhe vendimet pasuese u morën nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Megjithatë, dinamika e zgjedhjeve në Serbi, pastaj pezullimi i dialogut nga Parlamenti i Kosovës dhe zgjedhjet në Kosovë kanë penguar rifillimin e zbatimit.

Kosova e ka njoftuar BE-në për gatishmërinë e saj për zbatim dhe insistoi që palët të pajtohen në një afat të ri, përmes komunikimit online.

c. Gjendja e zbatimit: Progres në zbatim (ende jo funksional)

5. Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e Përgjithshme/Elementet Kryesore (gusht 2015)²⁸

a. Përmbajtja

Palët kanë rënë dakord që të krijohet një Asociacion/Bashkësi e 10 komunave me shumicë serbe në Kosovë, e cila do të ketë 'një pasqyrë të plotë të fushave të zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural'²⁹ dhe kompetencave të

²⁷ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Marrëveshja për reciprocitet në tabela të automjeteve dhe heqja e tabelave ilegale u përmbyll sot në Bruksel'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/marreveshja-per-reciprocitet-ne-tabela-te-automjeteve-dhe-heqja-e-tabelave-ilegale-u-permbyll-sot-ne-bruksel/> [Qasur më: 9 tetor 2019].

²⁸ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore'. Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_final.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

²⁹ Po aty., fq.1

tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Anëtarësimi është i hapur për çdo komunë tjetër përderisa të gjithë anëtarët pajtohen.

Ajo do të krijohet me statut, në të njëjtën bazë si statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Komunitat pjesëmarrëse kanë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre nëpërmjet Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive, 'në përputhje me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjin e Kosovës. Trupi do të ketë një rol përfaqësues tek autoritetet qendrore dhe do të ketë një vend në këshillin konsultativ të komuniteteve për këtë qëllim.

Më 25 gusht 2015, palët u pajtuan për një sërë "parimesh të përgjithshme/elementesh kryesore" të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe. Studimi përshkruan kornizën ligjore, objektivat, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, kapacitetin ligjor, buxhetin dhe mbështetjen.

b. Përpyjekjet për zbatim

Parimet e Përgjithshme/Elementet kryesore janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Më 26 dhjetor 2016, Gjykata Kushtetuese mori vendimin e saj, duke gjetur se nuk përputhej plotësisht me Kushtetutën e Kosovës. Prandaj, vonesa është shkaktuar kryesisht nga pala kosovare.³⁰ Ndonëse është e sigurtë se pjesa e mbetur e procesit, që përfshin Statutin e Asociacionit, duhet të jetë në përputhje me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, fati i Asociacionit/Bashkësisë do të varet shumë nga përmbajtja dhe rezultati i fazës përfundimtare të dialogut politik midis Kosovës dhe Serbisë në një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjore.

c. Gjendja e zbatimit: Disa përparime/Jo i përfunduar

6. Marrëveshja për Urën e Mitrovicës (Plani i BE-së për Zbatim)³¹

a. Përmbajtja

³⁰ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit' fq. 15. Në dispozicion në:

https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjenhezbatimineMarreveshjeveteBrukselit_16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

³¹ Zyra e Kryeministrit (2016), 'Dialogu i lehtësuar nga BE-ja: Implementimi i Marrëveshjes për Urën në Mitrovicë'. Në dispozicion në: <http://kryeministri-ks.net/dialogu-i-lehtesuar-nga-be-ja-implementimi-i-marreveshjes-per-uren-ne-mitrovice/> [Qasur më: 9 tetor 2019].

Më 25 gusht 2015, të dy palët u pajtuan që BE-ja të sponsorizonte një projekt për mbylljen e “Parkut të Paqes” dhe “rivitalizimin” e strukturës aktuale deri në fund të qershorit 2016. Sipas formulimit të marrëveshjes, rruga do të jetë “e hapur për të gjithë trafikun”.

Paralelisht, rruga qendrore e veriut të Mitrovicës, Mbreti Peter (Kralja Petra) duhet të ndalohet për kalimin e automjeteve në të njëjtin afat kohor.

b. Përpyekjet për zbatim

Struktura e urës është rivitalizuar nga BE-ja. Megjithatë, ajo ende nuk është e hapur dhe plotësisht funksionale.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje filloi vetëm pas arritjes së marrëveshjes së re të zbatimit në Bruksel më 5 gusht 2016, sepse vetëm atëherë, një vit pas arritjes së marrëveshjes (25 gusht 2015), Serbia tregoi gatishmërinë për zbatim.

Marrëveshja e 25 gushtit 2016 parashikoi që zbatimi do të finalizohet deri në qershor 2016, megjithatë dështoi si pasojë e mungesës së gatishmërisë nga Serbia. Gjithashtu, marrëveshja e arritur në korrik 2014 dështoi për të njëjtat arsye.

Ndërkohë, dy barrikatat e tjera të mbetura në Mitrovicën e Veriut gjithashtu janë larguar më 29 dhe 30 tetor 2016, falë iniciativave të qytetarëve të komunitetit serb dhe shqiptar.³²

Bazuar në marrëveshjen e Brukselit të datës 25 gusht 2015, heqja e barrikadës dhe rivitalizimi i Urës së Mitrovicës do të duhej të përfundonin jo më vonë se në fund të qershorit 2016. Megjithatë, pala serbe ka refuzuar të bashkëpunojë në zbatim.

c. Gjendja i zbatimit: Pjesërisht e kompletuar (ende jo funksionale)

³² Zyra e Kryeministrit (2016), ‘Raport mbi Gjendjen në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit’ fq. 11. Në dispozicion në: https://votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbigjendjenhezbatimineMarreveshjeveteBrukselit16qershor-25nentor2016_New_cMqEfvkj9k.pdf [Qasur më: 9 tetor 2019].

V. Përfundimet dhe Rekomandimet

Ky studim ka ofruar një pasqyrë të dokumentuar të një sërë marrëveshjesh të përfunduara në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si në nivelet teknike ashtu edhe në ato politike. Këtu mund të shihet se të paktën një numër marrëveshjesh kanë sjellë rezultate konkrete dhe zbatohen në të vërtetë, siç është marrëveshja për lirinë e lëvizjes (kartat e identitetit), integrimi i sistemit të drejtësisë ose shpërbërja dhe integrimi i ish-Mbrojtjes Civile brenda rendit të zakonshëm ligjor dhe institucional të Kosovës.

Më tej, mund të shihet se ende ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve të cilat zbatohen pjesërisht apo nuk zbatohen fare, megjithëse me përparim relativ në procesin e zbatimit. Sidoqoftë, në çdo rast, studimi ka tentuar të identifikojë palën kontraktuese specifike dhe të zbulojë faktorët që kanë kushtëzuar dhe/ose kanë ndikuar në moszbatim apo vonesat në zbatimin e marrëveshjeve të individualizuara.

Në këtë pikëpamje, një numër i rekomandimeve dalin natyrshëm:

- (1) Pika kryesore e përmbylljes dhe rekomandimi themelor është që, përtej statusit ekzistues të zbatimit të secilës marrëveshje, si çështje e parimit ligjor universal - përveç nëse palët bien dakord ndryshe ose modifikojnë reciprokisht marrëveshjet ekzistuese - ato janë të detyruara të përmbushin marrëveshjet e arritura. Kështu, të dyja palët janë të detyruara të zbatojnë marrëveshjet që ato kanë lidhur dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i zbatuar ato.
- (2) Secila nga palët mund të propozojë ose të fillojë modifikimin e ndonjë prej marrëveshjeve ekzistuese. Megjithatë, pëlqimi i palës tjetër kërkohet ashtu që diskutimi të fillojë dhe ndryshimet të materializohen.
- (3) Një nga marrëveshjet më të rëndësishme, e cila nuk është zbatuar e as nuk ka arritur progres, është Marrëveshja për Pranimin reciprok të Diplomave. Ajo që e bën mungesën e përparimit më shqetësuese është fakti se kjo është një nga marrëveshjet e para dhe në parim është më tepër një karakter teknik dhe profesional, sesa që ka të bëjë me ndjenja dhe besime të thella politike. Duket

qartë se pala fajtores për këtë ngecje është ajo serbe. Kosova duhet të kërkojë veprime konkrete, edhe përmes BE-së.

- (4) Ashtu si me Marrëveshjen për Pranimin reciprok të Diplomave, Kosova duhet të insistojë që Serbia të kthejë në Kosovë kopjet e skenuara të verifikuara të regjistrave kadastrale të marra nga Serbia.
- (5) Kosova duhet të vazhdojë të jetë pjesë aktive e forumeve dhe organizatave rajonale dhe t'i rezistojë çdo pengese të mundshme nga zyrtarët e Serbisë në bazë të Marrëveshjes për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal. Lidhur me këtë, Kosova duhet të insistojë në zbatimin e pjesëve të mbetura të Marrëveshjes për Zyrtarët Ndërlidhës, siç është marrëveshja për personelin dhe lokalet shtesë, si dhe përcaktimin e simboleve zyrtare të të dy Zyrave Ndërlidhëse.
- (6) Kosova ka fituar ligjërisht mosmarrëveshjen lidhur me energjinë në vitin 2008, kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vendosi që Serbia kishte shkelur traktatin e Athinës në lidhje me Kosovën. Prandaj, Kosova duhet të kërkojë veprim nga Komuniteti i Energjisë dhe BE-ja si një palë e Traktatit që do të mundësonte zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Energjisë për vitin 2013.
- (7) Kosova e ka vonuar zbatimin e Marrëveshjes për Reciprocitet në Targat e Automjeteve. Megjithatë, deri më tani i ka miratuar të gjitha vendimet e nevojshme për të realizuar zbatimin, kështu që nuk ka asnjë arsye që të shtyhet më tej zbatimi i kësaj marrëveshjeje.
- (8) Vonesa në zbatimin e marrëveshjes për Asociacionin/ Bashkësinë e komunave serbe është shkaktuar nga ana e Kosovës, megjithëse janë ndërmarrë hapa të caktuar; midis të tjerave, edhe Marrëveshja e Brukselit që siguron Asociacionin/Bashkësinë edhe *dokumenti* me titull "Parimet e përgjithshme/elementet kryesore" janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Gjykata ka marrë vendimin e saj, duke gjetur se një numër rastesh të mospërputhjes me Kushtetutën e Kosovës. Marrëveshja ndërmjet palëve parashikon këtë kompetencë shqyrtuese nga Gjykata, duke pranuar kështu mundësinë që ajo të gjejë mangësi kushtetuese në pjesë ose aspekte specifike

të saj, të cilat duhet të adresohen dhe të pasqyrohen në procesin e hartimit të Statutit të Asociacionit/ Bashkësisë .

(9) Si një detyrim kontraktual dhe një tregim i angazhimit ndaj vlerave evropiane, pala serbe duhet të bashkëpunojë në heqjen e pengesave përfundimtare që po pengojnë rivitalizimin e Urës së Mitrovicës.

